



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E DYTË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **18.03.2026 (e mërkurë)**, në zyrën e kryesuesit të Kuvendit Komunal të Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Ilir Zuka, z.Basri Aliu, zn.Zejnepe Osmani, z.Jakup Demiri, zn.Liridona Bislimi, znj.Elsa Jahija. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se janë prezent të gjithë anëtarët e KPF-së dhe ka kourum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Përsëritet për nënkryetarin e komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, drejtorët që janë prezent në këtë mbledhje. Mirë se keni ardhur në mbledhjen e dytë të rregullt të KPF-së. Pra, materialin e keni marrë me kohë, konfirmimin e ligjshmërisë e kemi pranuar për një vendim që është kthyer në rishqyrtim, të cilin duhet ta shfuqizojmë, sepse është në kundërshtim me Planin Hapësinor Zhvillimor. Para se me hy në rend të ditës, hapim diskutim.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Përsëritet të nderuar të pranishëm. Sot dikun në ora 8 e 15 minuta e kam pas një thirrje telefonike nga KEDS, e ku është edhe interes i joni, dhe këta e kanë me një kërkesë që me dhënë pronën me e ngrit një trafo në rrugën e Mogillës. Prona ish e Komunës, dhe tani me duhet konsultimi, a me e lëshu për kuvend tani ne, që me ja dhanë pronën në shfrytëzim apo sipas disave në Urbanizëm, thanë se mundemi me kalu edhe me leje të urbanizmit, po nëse nuk bëhet me Urbanizëm, ju njoftoj se duhet me prurë në Kuvend drejtpërdrejt si pikë shtesë.

z.Basri Aliu: Kjo procedurë shkon me Kuvend. Gjithëherë e kemi dhënë pronën në shfrytëzim me Kuvend. Caktohet lokacioni dhe i jepet në shfrytëzim KEDS-it për 15 vite në shfrytëzim.

z.Ilir Zuka: Ne me herët u konsultum dhe u pajtum se duhet me kalu, se është interesi i qytetarëve dhe duhet me ardh pikë në Kuvend direkt, sepse tani nuk kemi material në Kuvend me ardh.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nënkryetar, sa e di une, me drejtorin e Urbanizmit nuk lejohet, sepse ata japin vetëm pëlqim, ndërsa ne duhet me dhënë në shfrytëzim të pronës dhe duhet me ardhë në kuvend. Kështu kemi vepru me të gjitha pronat që i kemi dhënë në shfrytëzim. Nënkryetar, e kemi edhe një rast që një vit e tepër e kemi, një rast që u bë konstruksioni, e trafen nuk e kanë vendos. Këtu te ky Imeri që është berberi, për ditë më ndal me pyet te hymja e Ramjanit prej Dardanisë. E kemi pas një takim me Fatlumin dhe përfaqësuesen e departamentit për demokratizim të OSBE-së para një viti. E kemi një kërkesë për një deklaratë me e miratu në kuvend; e kishin miratu Kuvendi i Kosovës edhe disa kuvende të tjera, edhe e kanë kërku nga ne.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Jemi pro miratimit, sepse kjo është performancë për Komunën.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A jeni pra që kjo pikë të hin në rend të ditës? Dhe kemi një propozim vendim, që është i kundërligjshëm për çerdhe në Sllatinë, i cili nuk është konform Planit Zhvillimor Komunal, se në plan ish e parapamë që, çerdhja duhet të jetë në vendin e Zyrës së Vendi. Duhet të ndërrohet. Ne duhet në këtë seancë me shfuqizu, tani senacen tjetër me e rregullu.

znj.Liridona Bislimi: Përhëndetje të nderuar të pranishëm. Në mbledhjen e fundit të KPF kemi diskutu për parcelën e cila gjindet në fsh. Drobesh, përballë Ela Center. Tek ajo pjesë janë bërë mbeturina inerte, po më intereson kush është përgjegjës për atë parcelë. Nënkrjetar, nëse ki mundësi me na dhan një përgjigje për këtë. Dhe çështja tjetër që deshta me e diskutu: te komisioni për formimin e emërimit të rrugëve dhe rrugicave. Unë jam vitin e 9 asamblist dhe dy herë është formu ky komisioni. Unë kam qenë pjesë e këtij komisioni, as edhe një mbledhje të vetme nuk e kemi organizu. Edhe para se me qenë unë pjesë e komisionit, janë dikun mbi 60 rrugë që janë me disa gabime gjatë emërtimeve. Po e imagjinoni, tani janë shkru edhe do rrugë të reja. Edhe mu çka më ra në sy: në faqen zyrtare, në fsh. Sadovinë ish bërë një shtrim i rrugës dhe emërtimi i rrugës, që më erdhi shumë mirë. Po deshta me u interesu si u bërë kjo, a lejohet kjo, a duhet me vepru edhe banorët e fshatrave të tjera, çfarë procedure kanë ndjek ata, për shkak se është shumë e rëndësishme kjo. Unë e di që normal komisionit i ka skadu afati. A ka mu ftu komisioni tjetër? Kërkesa kryesore është që mos me u përsërit prapë që tetë vite ajo procedurë që asnjë vendim nuk është marrë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Vetëm duhet me pa afatin ligjor a kemi të drejt me ndërhy, a ka kalu afati, sepse e di që ka mbi 50 kërkesa, ndërsa sa i përket tek fshati Sadovinë, e banë me kërkesën. Po ju kemi kthi që ende nuk ka komision, e ata vet e kanë me atë emërtim të rrugës.

z.Hasan Aliu nënkryetar i komunës: Liridona, edhe unë jam interesu edhe e kam pyet zyrtarin kompetent për këtë çështjen e emërimit të rrugëve. Afatshmëria e tyre ish dhjetë vite, po çështja e afatshmërisë ka fillu prej momentit kur ka hi në Agjencionin Kadastral të Kosovës, dhe ajo periudhë nuk i ka dhjetë vite. Se vjet kam bisedu me Sadatin, ish kanë viti i gjashtë se vjet i kishin shti. E shtrohet pyetja: a duhet me ekzistiu një komision për emërtimin e rrugëve dhe shesheve? Unë konsideroj që po, se këto që i kanë marrë nga lista rezervë ai duhet me hi në kuvend, e ky komisioni duhet me ja dhan bekimin. Por megjithatë duhet me ekzistiu si komision, e deri sa ki emra rezervë, emërtim të ri nuk mundesh me ba rrugë të re. Po qujke në rast se i ka dhjetë e më tepër shtëpi. E për emrat rezervë që i ka Drobeshi, që janë mbi dhjetë, nuk është problem – duhet me shku ju me përzgjedhë emrin e ja jepni komisionit, komisioni del me propozim.

z.Illir Zuka: Ju tha se e kam marr emrin e rrugës, kanë ardh e kanë zgjedh. A u kanë deshtë me qenë qaj komisin që u kanë zgjedh prej kuvendit, me qenë pjesë e atij procesi?

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Emrat e rrugëve edhe emrat rezervë i ka kalu kuvendi, komisioni e ka për detyrë për rrugët e reja.

znj.Liridona Bislimi: Kryesues, që tetë vite kam qenë pjesë e këtij komisioni, nuk kemi pas asnjë angazhim, e tash është interesu një qytetar për këtë pjesë, edhe vjen më takon mu tash. Unë jam pjesë e këtij komisioni, edhe unë i thamë pa kalu dhjetë vite nuk mundem me bërë asgjë. Çka po i bjen funksioni i këtij komisioni?

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Sadati na thotë, se edhe rruga kryesore, nuk ka të drejtë të preket emri i saj. Po nëse është segmet i saj, merret nga lista rezervë.

z.Illir Zuka: Vitin e kaluar e kemi bërë vendosjen e numrave nëpër shtëpi, e një pjesë e numrave në Pozharan kanë mbet pa përfundu, se kanë pas problem me shtypjen e numrave, dhe erdh koha e zgjedhjeve, e tash është mirë me u merr me këtë, se në Pozharan nuk janë krejt numrat e shtëpive të vendosuara, sidomos në lagjen tonë mungojnë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Tek rendi i ditës, materialin e keni marr me këto dy pika shitesë: A jeni të miratohet rendit i ditës? Nga të gjithë të pranishmit u miratu rendi i ditës.

R e n d d i t e

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e Komitetit për Politikë dhe Financa.**
- 2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026.**

3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e marrëveshjes së binjakëzimit mes Komunës së Vitisë dhe Komunës së Saint Julien en Genevois – Francë.**

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e Komitetit për Politikë dhe Financa**

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nga të gjithë të pranishmit u miratu procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026**

znj.Majlinda Ostergllava, drejtoreshë e Kadastrit: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Lista është thuaja se e njëjtë me të vitit të kaluar, vetëm dy vende janë shtu, në Zhiti dhe në Sllatinë. Materialin e keni marr me kohë, për pyetjet shtesë jam në dispozicionin e juve.

z.Basri Aliu: Drejtoreshë, qeto prona a janë bërë me kërkesë të qytetarëve apo vetëm kështu?

znj.Majlinda Ostergllava, drejtoreshë e Kadastrit: Ne si komunë e verifikojmë se, cilat prona mujnë me u dhënë në shfrytëzim. Cilat janë të gatshme, nuk kanë probleme, dhe i paraqesim.

z.Basri Aliu: U kanë edhe një kërkesë e një qytetari atje që, me hi edhe ajo në listë, po nuk e pashë këtu, në fshatin Remnik i Ri.

znj.Majlinda Ostergllava, drejtoreshë e Kadastrit: Mundet me pas të interesum, po kërkesë nuk kemi pas për këtë, kërkesë zyrtare në Kadastër për këtë nuk kemi pas.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A jeni që kjo pikë të shkon në kuvend? Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Propozimin e keni marrë me kohë. Kjo parcelë ka qenë në procedurë po jan shpall zgjedhjet e u pezullu parcela.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A jeni që kjo pikë të shkoj në kuvend? Pra, me të gjithë të pranishmit pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, edhe kjo pikë shkon në kuvend.

Si pikë e katër e rendit të ditës:

4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e marrëveshjes së binjakëzimit mes Komunës së Vitisë dhe Komunës së Saint Julien en Genevois – Francë**

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Marrëveshjen e kemi nënshkru, e kemi pas autorizimin me herët prej kuvendit. Kërkojmë që të miratohet edhe kjo pikë.

znj.Liridona Bislimi: Kemi kalu edhe marrëveshje të tjera, po çka po përfiton Komuna e Vitisë me këtë marrëveshje, se kjo duhet me qenë në favor të Komunës së Vitisë, po po du me pas informacione me të gjerishme për këtë marrëveshje, dhe kërkoj që me qenë me transparent, se edhe web faqja e komunës i përcjell, sa shumë transparencë, ku mungojnë dhe emrat e këshilltarëve komunal.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Unë në plotni pajtohem kur kërkohet një transparencë sa më e madhe. Kurrë mos prit që marrëveshje e nënshkrua ndërmjet dy komunave do të bëjnë mrekulli, se ti mos i prit

që ata me të nimi në këtë drejtim. Saint-Julien-en-Genevois është në pjesën franceze, afër Zvicrës, është bukur shumë e dominuar tash nga shqiptarët dhe ata e zhvillojnë bukur edhe jetën sportive e kulturore. Kanë qenë një grup i sportistave këtu, e kanë vizitu klubin futbollistik, e interesi më i madh është me e rujt atë botën shqiptare, mos me e lan me na u asimilu, edhe me e lidh ata pak me vendlindjen e vet. Dhe kur ka naj projekt nga Bashkimi Evropian, se a ka marrëveshje me naj komunë tjetër, e plotësojmë si kriter.

z.Illir Zuka: Është shumë e mirë kjo marrëveshje dhe jam pro. Këta kanë qenë në vizitë në Pozharan, ka qenë një ditë feste. Po deshta me thanë që këto komuna ku po bëjmë binjakëzim, pse nuk e bëjmë naj marrëveshje që dy kuvendet me i shkëmby mënyrën e mbajtjes së kuvendeve, ato përvojat e ndryshme të atyre dhe tonat. Ka pas një vizitë shumë të mirë shkolla e Ramjanit, ku ata nga Tirana kanë qenë në Viti, po tash kanë qenë këta nga Ramjani në Tiranë. Edhe unë po mendoj që si kuvend duhet me e bë këtë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Duhet me shku në Shqipëri kur të kanë ata Kuvend, me e pa.

z.Basri Aliu: Çdo binjakëzim mendoj që e ka një pozitivitet, si që thojshin pleqt: “ku të shkojsh me ba një shpi”. Edhe kjo marrëveshje ka rrjedh nga mërgata jonë dhe jemi pro kësaj marrëveshjeje.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A jeni qe kjo pik të shkon ne kuvend nga te gjith të pranishmi u miratu edhe kjo pik e rendit të ditës.

Si pikë e pestë e rendit të ditës:

- 5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për shfuqizimin e Vendimit Nr.01-110/05-277, të datës 02.03.2026 për ndërrimin e destinimit të parcelave të propozuara me Nr.1088-0, me sipërfaqe 17758 m² në pronësi juridike të "D.S Osnova Shkolla", e cila parcelë do të destinohet për ndërtimin e çerdhes, dhe parcela në të cilën do të ndërtohet çerdhja do të jete parcela Nr.1088-2, me sipërfaqe 4000 m².**

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ministria naj ka kthy vendimin, i cili është jo në përputhje me ligjin, është në kundërshtim me Planin Zhvillimor Komunal, e aty parashihet pjesa tjetër. Tani ne duhet ta qesim me Kuvend. A jeni që kjo pikë të shkoj në Kuvend? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, dhe kjo pikë shkon në kuvend.

Si pikë e gjashtë e rendit të ditës:

- 6. Aprovimi i Deklarates mbështetëse kundër dhunës, e cila është miratu në Kuvendin e Kosovës**

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A jeni që kjo pikë të shkon për në Kuvend? Me votat e të gjithëve edhe kjo pikë shkon në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në ora 11:30

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi